

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim
zgjidhjet**

P6

Data 30/10/2021

Detyra 1

Sky Shpk, me qendër në Prishtinë, është një prodhues i nivelit të lartë të produkteve të specializuara të lëndëve të para që u shesin kompanive që operojnë në sektorin e pajisjeve mjekësore. Ju jeni senior i auditimit në angazhim dhe ju jeni prezantuar me informacionin e mëposhtëm nga kontabilisti i kompanisë në lidhje me pasuritë joqarkulluese për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020:

	Ndërtesat	Pronat investuese	Automjetet	Pajisjet e zyrës
Kosto	€	€	€	€
Me 1 janar 2020	4,000,000	5,000,000	50,000	800,000
Shtesat	1,000,000	2,000,000	10,000	50,000
Heqjet/shitjet			(5,000)	
Me 31 dhjetor 2020	5,000,000	7,000,000	55,000	850,000
Zhvlerësimi i akumuluar				
Me 1 janar 2020	400,000		20,000	160,000
Zhvlerësimi i vitit	200,000		5,250	85,000
Heqjet/shitjet			(1,000)	
Me 31 dhjetor 2020	600,000	-	24,250	245,000
Metoda e zhvlerësimit	Lineare		Saldo zbritëse	Lineare
Norma vjetore e zhvlerësimit	4%		15%	10%

Shënime:

- Drejtorët e kompanisë rivlerësojnë pronat investuese në mënyrë periodike bazuar në rritjen e çmimeve të qirasë dhe pronës në Prishtinë.
- Kompania bleu një pronë të re investuese në qershor 2020 për 1,500,000 €, por më pas e rivlerësoi këtë pronë në 2,000,000 €.
- Kompania bleu të gjitha pronat e saj investuese me shpresën se do të kalonte në prona për të zgjeruar prodhimin e pajisjeve mjekësore. Megjithatë, për shkak të blerjes së një ndërtese të re e cila është ngjitur me ndërtesën e saj origjinale, Sky tani u jep me qira të gjitha pronat investuese palëve të treta.

Kërkohet:

- Përshkruani DY pohime të rëndësishme të auditimit në lidhje me pronat, objektet dhe pajisjet. (4 pikë)
- Përshkruani testet thelbësore (pavarura) për pasuritë joqarkulluese, duke përfshirë zhvlerësimin, në lidhje me Sky për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Ju duhet të nënvizoni edhe pohimet përkatëse që testohen. (14 pikë)
- Shpjegoni dhe diskutoni se çfarë nënkuptohet me Regjistrin e pasurive joqarkulluese dhe përshkruani hapat që ju, si auditor, duhet të ndërmerreni për të konfirmuar që regjistri është i përditësuar dhe mund të mbështeteni gjatë testimit të auditimit. (4 pikë)
- Kodi i qeverisjes korporative thotë se duhet të ketë një procedurë formale, rigoroze dhe transparente për emërimin e drejtorëve të rinj në bord. Diskutoni se si bordi i drejtorëve mund të sigurojë që procesi për emërimet e reja në bord përmbush këtë kërkesë të qeverisjes së korporatës. (8 pikë)

[Gjithsej: 30 pikë]

Zgjidhja

a) Ekzistenca (E): PJQ e regjistruara në kontabilitet, eksitojnë

Të drejtat dhe detyrimet (D/D): Që entiteti ka të drejtën e kontrollit mbi PJQ të cilat janë të kontabilizuara.

Saktësia/Vlerësimi (C/V): PJQ mbahen me shumat/vlerësimet e sakta në pasqyrat financiare.

Plotësia (P): PJQ në fund të vitit janë të kontabilizuar në libra dhe regjistrime.

Ndodhja (N): Që të gjitha shtesat dhe shitjet e PJQ në pasqyrat financiare kanë ndodhur (d.m.th. janë reale)).

Klasifikimi dhe Paraqitja (K/P): Që një zë është shpalosur/klasifikuar dhe shpaloset në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare.

Prerja (Pr): Që çdo shtesë ose shitje e PJQ, është regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

b) Shembuj të programit të auditimit për PJQ:

Testi	Pohimet
Politikat e kontabilitetit janë të duhura?	Vlerësim, Saktësi, Prerja
Merrni regjistrin e pasurive joqarkulluer, perputheni me librin kryesor dhe me saldo fillestare	Vlerësim, Saktësi, Plotësi, Prerja
Ndjekni shtesat me dokumente mbështetëse, raporte të bankës	N, S, Prerja, Ekzistnca, Te drejtat dhe obligimet
Ndjekni shitjet me dokumente mbështetëse, raporte të bankës	N, S, Prerja, Ekzistnca, Te drejtat dhe obligimet
Ndjekni pasuritë e rivlerësuara me dokumentet mbështetëse (raportin e vlerësuesit)	V, Prerja
Rishikoni vlerësimin e dëmtimit të pasurive nga klienti	V, Prerja
Inspektoni dokumentet e pronësisë nga palët e treta	E, të drejtat dhe obligimet
Inspektoni dokumentet e regjistrimit të automjeteve	E, të drejtat dhe obligimet
Inspektoni fizikisht pajisjet	E, të drejtat dhe obligimet
Rishikoni shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes	S, V, P

Veçanërisht për zhvlerësimin duhet:

- Rishikoni normat e amortizimit në lidhje me:
 - Jeta e dobishme e asetit
 - Vlera e asgjësimit
 - Politika e zëvendësimit
 - Përvoja e vitit të mëparshëm në lidhje me fitimin/humbjen nga nxjerrja jashtë përdorimit
 - Konsistenca me politikat e mëparshme kontabël
 - Vjetërim i mundshëm
- Verifikoni me regjistrin e pasurive, tarifat e zhvlerësimit për të gjitha pasuritë me jetë të kufizuar të përdorimit
- Për pasuritë e rivlerësuara, sigurohuni që të jetë ngarkuar zhvlerësimi i saktë në shumën e rivlerësuar
- Ri-kryeni dhe rillogaritni shpenzimet e zhvlerësimit
- Krahasoni normat e zhvlerësimit me raportin e viteve të mëparshme dhe metodën e zhvlerësimit

- Verifikoni që norma dhe metoda e zhvlerësimit janë shpalosur saktë në pasqyrat financiare.

Çështjet e vërejtura specifike për Skii Limited bazuar në informacionin e dhënë nga kontrolluesi financiar:

Elementi	Çështja	Rekomandimi
Politikat e kontabilitetit	Trajtim i gabuar i vlerësimit të pronave investuese	Kryeni një vlerësim të pronave nga një palë e tretë
Zhvlerësimi	Shpenzim i gabuar i zhvlerësimi	Rillogaritni zhvlerësimin dhe kryeni teste shtesë të zhvlerësimit nga lista e mësipërme
Klasifikimi dhe prezantimi	Klasifikim dhe prezantim i gabuar sipas SNK 16. Nuk ka vlerë neto në libra për pasuritë joqarkulluese	Sigurohuni se është bërë klasifikimi i duhur i zërave në tabelën e pasurive joqarkulluese

c) Regjistri i PJQ është regjistrim i PJQ të mbajtura nga një kompani. Ky është pjesë e sistemi i kontrollit të brendshëm të një organizate. Regjistri i PJQ është një lidhje kyçe për audituesin ndërmjet pasurive fizike dhe tepricave në librin kryesor

Detajet e mbajtura në një regjistër të tillë mund të përfshijnë:

- Kostoja
- data e blerjes
- përshkrimi i pasurisë
- numri i serisë/referencës
- vendndodhjen e pasurisë
- metoda e zhvlerësimit
- jeta e pritshme e dobishme
- vlera kontabël neto
- mbulimi i sigurimit.

Hapat që duhet të ndërmarrë një auditor për të konfirmuar se regjistri është i përditësuar:

- Merrni/përgatitni një përmbledhje të PJQ që tregojnë:
 - vlera kontabël bruto
 - zhvlerësimin e akumuluar
 - vlera neto në kontabilitet
- Të harmonizojë përmbledhjen me pozicionin e hapjes
- Të rakordojë librin kryesor të PJQ me regjistrin e pasurive, të marrë shpjegime rreth ndryshimeve
- Inspektoni fizikisht asetet e përmendura në regjistrin e pasurive
- Konfirmo artikujt se:
 - ekzistojnë
 - janë në përdorim
 - janë në gjendje të mirë
 - përputhen me numrin serial/referencë në regjistrin e PJQ
- Zgjidhni të gjitha ose përdoni një mostër të shtesave dhe shitjeve gjatë vitit që përfshihen në regjistrin e PJQ dhe ndjekini deri te dokumentacioni mbështetës

d) Bordi i Drejtorëve duhet të krijojë një komitet emërimi i cili do të udhëheqë procesin për emërimet dhe do t'i bënte rekomandime bordit. Komisioni i emërimit duhet të kryesohet nga kryetari dhe anëtarë duhet të jenë drejtorë joekzekutivë të pavarur, përveç rastit kur ndodh kryetari që zëvendësohet.

Termat e referencës së komitetit të emërimit duhet të përcaktohen qartë për të siguruar që ndërmerret një qasje rigoroze dhe formale ndaj emërimit. Kërkesa për tu emëruar si anëtarë i

bordit duhet të bëhet në bazë të meritës duke marrë parasysh nevojën për diversitet në bord duke përfshirë bazën gjinore.

Komiteti i emërimit duhet të marrë në konsideratë aftësitë, përvojën, pavarësinë dhe njohuritë që janë aktualisht në këtë fushë në bordin dhe të identifikojë rolin dhe aftësitë e nevojshme për emërimin e ri. Qëllimi është të sigurohet që bordi ka një ekuilibër të përshtatshëm të aftësive dhe përvojës dhe për të rifreskuar vazhdimisht aftësitë dhe talentet në bord. Bordi duhet të sigurojë që ka plane për një vazhdimësi të rregullt për emërimet në bord dhe menaxhment të lartë për të siguruar vazhdimësinë dhe planifikimin e vazhdimësisë.

Detyra 2

Ju jeni një menaxher auditimi që punon me SamSara Audit. Aktualisht jeni duke punuar në departamentin e kontabilitetit të firmës, si ekspert i brendshëm për ekipet e auditimit. Është 25 Mars 2021 dhe ju keni qenë me pushim vjetor për disa ditë dhe po prisni një ditë të gjatë dhe të ngarkuar për të kapur punën që keni humbur. Kur mbërrini në zyrë, keni katër posta zanore që kërkojnë përgjigje jashtëzakonisht urgjente për çështjet që ju janë dërguar me email. Një përmbledhje e çështjeve nga emaillet jepet më poshtë:

(i) Alfa Shpk (Alfa) është aktualisht e përfshirë në çështje gjyqësore. Alfa është paditur për shkelje të kontratës. Ekipi i auditimit ka shqyrtuar korrespondencën dhe ka marrë konfirmime nga avokatët e Alfa. Korrespondenca dhe konfirmimet theksojnë se klauzola në fjalë është subjektive dhe si e tillë, ata nuk janë në gjendje të konkludojnë nëse ka gjasa që Alfa të fitojë çështjen. Nëse Alfa humbet çështjen, pasojat do të kenë një ndikim të rëndë negativ në gjendjen e saj financiare. Alfa nuk e ka shpalosur këtë çështje në pasqyrat financiare.

(ii) VeV ShpK (VeV) ka një fundvit më 31 Mars 2021. Auditimi ka ecur mirë me përjashtim të llogarive të arkëtueshme. VeV u shet kryesisht shitësve të vegjël të gazetave që nuk u përgjigjen kërkesave për konfirmim dhe zakonisht janë të ngadaltë në pagesë. Si rezultat, ekipi i auditimit nuk ka qenë në gjendje të sigurohet për rikuperimin e llogarive të arkëtueshme dhe nuk pret që të jetë në gjendje ta zgjidhë këtë përpara se të nënshkruhet raporti i auditimit.

(iii) Quest Shpk (Quest) ka qenë historikisht në një situatë të përhershme mbitërheqjeje. Buxheti për 12 muajt e ardhshëm tregon një kërkesë të vazhdueshme për mbitërheqje. Kontrata e mbitërheqjes ka skaduar dhe Quest nuk ka arritur ende t'i rinegociojë ato për shkak të kontrolleve dhe kërkesave më të rrepta që janë sjellë në proceset e bankës së tyre që nga data e fundit e rinovimit. Nëse një mbitërheqje nuk mund të arranzhohet Quest nuk do të operojë sipas hipotezës së vijimësisë. Menaxhmenti është i bindur se një rinovim do të negociohet. Pasqyrat financiare duhet të nënshkruhen nga auditori pasi Quest duhet t'i dorëzojë ato te një autoritet rregullator për industrinë e tij më 30 qershor 2021. Ekipi i auditimit nuk mund të thotë nëse ka gjasë ose jo që Quest të jetë në gjendje të rinegociojë mbitërheqjen.

(iv) Tomi Shpk (Tomi) ka një fund viti më 31 dhjetor 2020. Tomi kishte një mosmarrëveshje me auditorët e saj të mëparshëm e cila u shndërrua në krizë në mars 2021. Tomi vendosi të ndryshojë auditorët në atë moment. Për shkak të emërimit të vonuar të SamSara, pjesëmarrja në numërimin e stoqeve në fund të vitit nuk ishte e mundur. Pas emërimit, u mor në konsideratë kryerja e një numërimi fizik në mars 2021 dhe rrillogaritja e stoqeve nga kjo datë prapa deri me 31 dhjetor, por u arritë në përfundim së bashku me Tomin se kjo nuk do të ishte e mundur për shkak të kufizimeve të sistemit brenda sistemit të menaxhimit të stoqeve.

Kërkohet:

(a) Përshkruani shkurt përmbajtjen kryesore të raportit të auditimit. (4 pikë)

(b) Lidhur me çështjet e auditimit (i) deri (iv), vlerësoni ndikimin e mundshëm në raportin e auditimit. (16 pikë)

(c) Shpjegoni termin 'Skepticizmi profesional' lidhur me auditimin dhe diskutoni rëndësinë e qenjes profesionalisht skeptik kur kryhen angazhimet për auditim. (5 pikë)

[Gjithsej: 25 pikë]

Zgjidhja

(a) Përmbajtja e një raporti auditimi të pamodifikuar duhet të përfshijë sa vijon:

- Titulli
- Adresuesin
- Paragrafi hyrës
- Përgjegjësitë përkatëse të të ngarkuarve me qeverisjen dhe auditorëve.
- Fushëveprimi i Auditimit të Pasqyrave Financiare
- Opinionin e Auditorëve
- Opinionet për çështje të tjera
- Data e raportimit
- Adresa e Zyrës
- Nënshkrimi i auditorit

(b)

Çështja (i): Alfa

Kjo çështje paraqet një pasiguri materiale. Nëse menaxhmenti ka dhënë informacione shpjeguese të përshtatshme adekuate, auditorit duhet të lëshojnë një opinion të pakualifikuar, të modifikuar nga një paragrafi i pasigurisë materiale. Nëse menaxhmenti nuk ka dhënë shpalosjet adekuate, auditorët duhet të japin një raport të kualifikuar ose opinion të kundërt. Duke qenë se kjo çështje është materiale, por jo e përhapur, opinionin do të kualifikojë me “përveç për” shpalosjet rreth çështjes ligjore.

Çështja (ii): VeV

Auditori duhet të kryejë procedura të tjera auditimi për t'u siguruar në lidhje me vlefshmërinë e saldove të LLA. Vetëm nëse kjo dhe punët të tjera të auditimit nuk arrijnë të ofrojnë siguri të duhur, raporti i auditimit mund të duhet të kualifikohet.

Çështja (iii): Quest

Kjo paraqet një pasiguri në lidhje me vijimësisë. Auditorët në këtë pikë nuk janë dakord me përgatitjen e PF mbi bazën e vijimësisë. Nëse menaxhmenti ka dhënë informacione shpjeguese të përshtatshme, auditori duhet të jap një opinion të pakualifikuar, të modifikuar nga një paragrafi i pasigurisë materiale. Nëse menaxhmenti nuk ka dhënë shpalosjet e duhura, auditorët duhet të japin një raport të kualifikuar.

Çështja (iv): Tomi

Ky përfaqëson një kufizim të fushëveprimit pasi auditorët nuk kanë qenë në gjendje të sigurohen për ekzistencën e stoqeve për shkak të rrethanave të emërimit. Në varësi të materialitetit dhe përhapjes së çështjes, duhet të lëshohet një raport i kualifikuar (përveç rasteve materiale, por jo të përhapura, opinion kundër në rastin material dhe të përhapur) duke përshkruar kufizimin dhe ndikimin e mundshëm në shifra nëse kufizimi nuk ekzistonte.

(c) Skepticizmi profesional është një qëndrim që përfshin një mendje dyshuese, duke qenë vigjilent ndaj kushteve që mund të tregojnë anomalitë e mundshme për shkak të gabimit ose mashtrimit, dhe një vlerësim kritik të dëshmive të auditimit.

ISA 200, Objektivat e Përgjithshme të Auditorit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, kërkojnë përdorimin e skepticizmit profesional si një mjet për të rritur aftësitë e auditorit për të identifikuar rreziqet e anomalive materiale dhe për t'iu përgjigjur rreziqeve të identifikuara.

Skepticizmi profesional është i lidhur ngushtë me konsideratat themelore etike të objektivitetit dhe pavarësisë së auditorit. Ky koncept është shumë i rëndësishëm nga këndvështrimi i auditimit dhe duke aplikuar skepticizëm profesional, kjo duhet të zvogëlojë rrezikun e moszbulimit sepse rrit efektivitetin e procedurave të auditimit të aplikuara dhe redukton

mundësinë që auditori të arrijë në një përfundim të papërshtatshëm gjatë vlerësimit të rezultateve të auditimit.

Detyra 3

FamaSoft Shpk (FamaSoft) është një kompani e specializuar e pajisjeve kompjuterike dhe ka mbi pesë vjet që tregton. Kompania financohet pjesërisht përmes huave dhe mbitërheqjeve dhe gjithashtu nga disa aksionarë të mëdhenj. FamaSoft ka përjetuar rritje të ndjeshme në vitet e mëparshme. Megjithatë, në vitin aktual, një konkurrent i ri PCT, hyri në treg dhe, nëpërmjet çmimeve konkurruese, fitoi një pjesë të konsiderueshme të tregut, kryesisht në dëm të FamaSoft. Një nga klientët më të mëdhenj të FamaSoft e ka zhvendosur biznesin e tij në PCT. Për më tepër, një numër i zhvilluesve të specializuar të FamaSoft janë larguar nga kompania dhe janë bashkuar me PCT. FamaSoft e ka pasur të vështirë zëvendësimin e këtyre punonjësve për shkak të nivelit të specializuar të aftësive dhe njohurive të tyre.

FamaSoft sapo ka marrë njoftimin se furnizuesi kryesor i saj, i cili i siguronte kompanisë pajisje elektrike të specializuara, është mbyllur.

FamaSoft po kërkon të zhvillojë produkte të reja për t'u diferencuar nga konkurrentët e saj.

Drejtorët kohët e fundit iu drejtuan aksionerëve të kompanisë për të kërkuar fonde shtesë për të financuar këtë zhvillim. Megjithatë, aksionerët nuk duan të investojnë më tej në këtë moment.

Huaja e FamaSoft është afatgjatë dhe kompania i ka përmbushur të gjitha pagesat në kohë.

Mbitërheqja e kompanisë është rritur ndjeshëm gjatë vitit. Drejtorët ju kanë informuar se kontrata e mbitërheqjes pritet të rinovohet muajin e ardhshëm dhe janë të bindur se do të rinovohet. Drejtorët kanë prodhuar një parashikim të rrjedhës së parasë, i cili tregon një përkeqësim të ndjeshëm të pozicionit gjatë 12 muajve të ardhshëm. Në përgjithësi, megjithatë, drejtorët janë të sigurt në lidhje me produktet e reja që po zhvillohen. Duke u bazuar në historinë e tyre të rritjes së konsiderueshme, ata besojnë se nuk është e nevojshme të bëhet ndonjë shpallje në pasqyrat financiare në lidhje me vijimësinë.

Kërkohet:

(a) Përshkruani se çfarë nënkuptohet me 'vijimësi' dhe përshkruani përgjegjësinë e menaxhmentit në lidhje me vijimësinë. (5 pikë)

(b) Përshkruani përgjegjësinë e auditorit në lidhje me vijimësinë. (5 pikë)

(b) Vlerësoni GJASHTË tregues të mundshëm që FamaSoft mund të mos jetë duke operuar sipas vijimësisë. (6 pikë)

(c) Vlerësoni procedurat kryesore të auditimit që duhet të kryhen për të identifikuar këta tregues nëse FamaSoft është duke operuar sipas vijimësisë. (9 pikë)

[Gjithsej: 25 pikë]

Zgjidhja

(a) Parimi i vijimësisë është supozimi se një kompani do të mbetet në biznes për të ardhmen e parashikueshme. ISA 570 Parimi i vijimësisë, merret me përgjegjësitë e auditorit në auditimin e përdorimit nga menaxhmenti të bazës së vijimësisë në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Standardi përcakton objektivat e punës së auditorit dhe kërkesat specifike që duhen përmbushur. Për më tepër, SNA 570 sqaron përgjegjësitë përkatëse të menaxhmentit të kompanisë dhe auditorit në vlerësimin e aftësisë së entitetit për të vazhduar biznesin në vijimësi.

Përgjegjësia e menaxhmentit në lidhje me vijimësinë është të ndërmarrë vlerësimin e vijimësisë dhe të japë informacione shpjeguese në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ata duhet të marrin në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat në lidhje me të ardhmen e parashikueshme të një entiteti të ditura në datën e miratimit të pasqyrave. Do të ishte e këshillueshme që vlerësimi të përfshijë, minimalisht, përgatitjen e një buxheti, vlerësimet e tregtimit dhe parashikimet e flukseve monetare dhe një analizë të kërkesave dhe lehtësive për huamarrje të kompanisë. Gjatë kryerjes së vlerësimit të vijimësisë, menaxhmenti do të duhet të vlerësojë se cili nga tre përfundimet e mundshme është i përshtatshëm për rrethanat e kompanisë. Në veçanti ata mund të konkludojnë se:

- Nuk ka pasiguri materiale që mund të ngrenë dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e kompanisë për të operuar me vijimësi
- Ka pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme në lidhje me aftësinë e kompanisë për të operuar si vijimësi, por përdorimi i bazës së vijimësisë mbetet i përshtatshëm; ose
- Përdorimi i vijimësisë nuk është i përshtatshëm.

Menaxhmenti i kompanisë ka ndërmarrë tashmë disa nga veprimet e mësipërme, por ata besojnë se është e panevojshme të bëhet ndonjë shpallje në pasqyrat financiare në lidhje me vijimësinë. Kjo do të duhet të bihet dakord nga auditorët dhe sipas gjykimit të auditorit, nëse përdorimi i bazës së kontabilitetit të vijimësisë nga menaxhmenti në përgatitjen e pasqyrave financiare është i papërshtatshëm, auditori duhet të shprehë një opinion të kundërt.

(b) Më poshtë janë disa tregues të mundshëm që sugjerojnë se kompania nuk është duke operuar sipas vijimësisë:

- Konkurrent i ri: kompania ka përjetuar rritje të konsiderueshme në vitet e mëparshme, megjithatë, në vitin aktual dhe konkurrenti i ri PCT, ka hyrë në treg dhe nëpërmjet çmimeve konkurruese ka fituar një pjesë të konsiderueshme të tregut nga kompania - Kjo mund të sugjerojë se kompania nuk është duke operuar sipas vijimësisë pasi PCT ka fituar tashmë një pjesë të pjesës së tyre të tregut dhe kjo nuk është mirë për të ardhmen nëse kompania nuk mund të diferencohet nga konkurrentët e tyre.
- Humbja e klientit të madh: Një nga klientët më të mëdhenj të FamaSoft ka ndaluar tregtimin me ta dhe e ka zhvendosur biznesin e tij në PCT. Kjo e forcon më tej PCT-në dhe është shqetësuese për Fama. Do të na duhet të shqyrtojmë se çfarë përqindje të të ardhurave përfaqësonte ky klient dhe nëse ishin të ardhura të përsëritura. Nëse përfaqësonte një pjesë të madhe të shitjeve vjetore, mund të sugjeronte që Fama nuk duke operuar sipas vijimësisë.
- Humbja e stafit kryesor: Një numër i zhvilluesve të specializuar të Fama janë larguar nga kompania dhe i janë bashkuar PCT-së. Fama e ka pasur të vështirë zëvendësimin e këtyre punonjësve për shkak të nivelit të aftësive dhe njohurive të tyre. Kjo është alarmante për Fama pasi stafi kryesor është larguar dhe i është bashkuar konkurrentit të tyre kryesor. Aftësitë dhe

njohuritë e tyre janë një avantazh konkurrues për konkurrentët e tyre, por pamundësia e Fama për t'i zëvendësuar ato mund të sugjerojë që Fama nuk është duke operuar sipas vijimësisë.

- Ndërprerja e furnizimit nga furnitori kryesor: Fama ka marrë njoftimin se furnizuesi kryesor i saj që i ka ofruar kompanisë pajisje elektrike të specializuara ka pushuar së tregtuari. Në varësi të marrëveshjeve të furnizuesit dhe furnitorëve që punojnë me PCT, ata mund ta kenë shumë të vështirë të marrin furnizues të rinj me një çmim të përballeshëm. Kjo mund të sugjerojë se Fama mund të ketë problem me vijimësinë
- Kërkesat për financim të ardhshëm: Fama ka kërkuar nga aksionrët e saj për të financuar zhvillimin e ardhshëm dhe për të kërkuar financime të mëtejshme, megjithatë, ata nuk donin të investonin më tej në këtë moment. Ata kanë rritur ndjeshëm mbitërheqjen gjatë vitit dhe drejtorët kanë deklaruar se kontrata e mbitërheqjes do të rinovohet muajin e ardhshëm. Ky është një tjetër shkak shqetësimi për Fama pasi për shkak të hyrjes së një konkurenti të ri të madh, humbjes së stafit kyç dhe problemeve me klientët dhe furnitorët e mëdhenj, pritet që ata të kenë nevojë për fonde të mëtejshme për të zhvilluar produkte të reja. Nëse ata nuk janë në një pozicion të mirë financiar, kjo mund të ngecë rritjen e tyre të mëparshme, gjë që mund t'i çojë ata të mbeten prapa konkurrentëve të tyre, gjë që mund të zvogëlojë më tej pjesën e tyre të tregut.
- Parashikimet e rrjedhës së parasë: Drejtorët kanë përgatitur një parashikim të rrjedhës së parasë, i cili tregon një përkeqësim të ndjeshëm të pozicionit gjatë 12 muajve të ardhshëm. Për të shqyrtuar nëse një kompani është në vijimësi apo jo, parashikimet e rrjedhës së parasë dhe parashikimet e ardhshme janë thelbësore. Nëse drejtorët kanë përgatitur parashikime përkeqësuese të rrjedhës së parave, ky është një shqetësim i madh për Fama dhe do të sugjeronte përsëri se ata nuk janë duke operuar sipas vijimësisë.

(b) ISA 570 përshkruan qartë objektivat e auditorit në lidhje me përdorimin e bazës së vijimësisë:

- Për të marrë evidencë të mjaftueshme të përshtatshme në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së vijimësisë nga drejtimi
- Për të përfunduar, mbi bazën të evidencës së auditimit, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar si vijimësi; dhe
- Për të përcaktuar implikimet për raportin e auditorit.

ISA 570 kërkon që auditori të marrë në konsideratë vazhdimin e aktivitetit në fazat e hershme të auditimit, veçanërisht kur kryen procedurat e vlerësimit të rrezikut në fazën e planifikimit. Në atë moment, audituesi duhet të marrë në konsideratë nëse ka ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme për supozimin e vijimësisë.

(c) Ngjarjet dhe kushtet që mund të hedhin dyshime në supozimin e vijimësisë mund të jenë të natyrës financiare, operative ose të tjera. ISA 570 thekson një sërë ngjarjesh dhe kushtesh të tilla që hasen zakonisht në jetën reale dhe me të cilat auditori duhet të njihet.

Ato përfshijnë pasiguri financiare dhe operationale, disa prej të cilave janë qartësisht të dukshme në Fama. Më poshtë është një mostër e procedurave që mund të sugjerojnë nëse një kompani është në vijimësi apo jo:

Financiare:

- Detyrimi neto ose pozicioni neto i detyrimit aktual.

- Huamarrjet me afat të caktuar që i afrohen maturimit pa perspektiva reale rinovimi ose shlyerjeje; ose mbështetje e tepruar në huamarrjet afatshkurtra për financimin e aktiveve afatgjata.
- Tregues për tërheqjen e mbështetjes financiare nga kreditorët.
- Rrjedhat monetare negative operative të treguara nga pasqyrat financiare historike ose të ardhshme.
- Raportet kryesore të pafavorshme financiare.
- Pamundësia për të marrë financim për zhvillimin thelbësor të produktit të ri ose investime të tjera thelbësore.

Operacionale:

- Synimet e menaxhmentit për të likuiduar entitetin ose për të ndërprerë veprimtarinë.
- Humbja e menaxhmentit/stafit kyç pa zëvendësim.
- Humbja e një tregu të madh, klient(ve), ekskluzivitet, licencave ose furnitorëve kryesor.
- Vështirësitë me fuqinë punëtore.
- Mungesa e furnizimeve të rëndësishme.
- Shfaqja e një konkurenti shumë të suksesshëm.

Procedurat që auditori duhet të marrë në konsideratë për të ndërmarrë janë si më poshtë:

- Një rishikim i planeve të menaxhmentit për veprimet e ardhshme në lidhje me vijimësinë, duke përfshirë, për shembull, pyetjet në lidhje me planet e tyre për të likuiduar pasuritë, për të marrë hua ose për të ristrukturuar borxhet, për të reduktuar ose vonuar shpenzimet ose për të rritur kapitalin, në mënyrë që të përcaktohet nëse ato janë të realizueshme dhe kanë gjasa të përmirësojnë situatën.
- Nëse entiteti ka përgatitur parashikime të rrjedhës së parasë dhe shqyrtimi i tyre është kritik në planet e menaxhmentit në lidhje me vijimësinë, auditori duhet të vlerësojë besueshmërinë e të dhënave bazë të përdorura në parashikime dhe të përcaktojë nëse supozimet në bazë të parashikimit mund të mbështeten në mënyrë adekuate me dëshmi. Analiza e parashikimeve të rrjedhës së parasë mund të zgjerohet gjithashtu duke krahasuar parashikimet për periudhat e fundit të mëparshme me rezultatet historike dhe parashikimet për periudhën aktuale me rezultatet aktuale deri më sot.
- Shqyrtimi nëse ndonjë fakt apo informacion shtesë është bërë i disponueshëm që nga data e vlerësimit të menaxhmentit.
- Kur supozimet e menaxhmentit përfshijnë mbështetjen e vazhdueshme financiare nga palët e treta dhe një mbështetje e tillë është e rëndësishme për aftësinë e entitetit për të vazhduar si vijimësi, auditorit mund t'i duhet të kërkojë konfirmime me shkrim, duke përfshirë termat dhe kushtet, nga këto palë të treta dhe të marrë dëshmi për aftësinë e tyre për të ofruar mbështetje.
- Përfaqësimet me shkrim nga menaxhmenti në lidhje me planet e tyre të veprimit të ardhshëm dhe realizueshmërinë e planeve.
- Kryerja e procedurave të auditimit në lidhje me ngjarjet e mëvonshme për të identifikuar ato që zbusin ose ndikojnë ndryshe në aftësinë e entitetit për të vazhduar si vijimësi. Mbi bazën e dëshmive të marra, auditori duhet të konkludojë nëse ekziston një pasiguri materiale që mund thedhë dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e entitetit për të vazhduar si vijimësi.

Detyra 4

Ju jeni seniori i auditimit të A1 Audit dhe po planifikoni auditimin e Barna Shpk. (Barna). Firma ka audituar Barna për pesëmbëdhjetë vitet e fundit. Fushëveprimi i auditimit është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit duke rezultuar në rritje të ndjeshme të tarifave të auditimit. Tarifa e auditimit për Barna për vitin aktual pritet të jetë 300,000€. Të ardhurat totale të buxhetuara nga tarifat e firmës suaj për vitin aktual pritet të jenë 1,600,000 €. Tarifa e auditimit nga viti i kaluar për Barna është ende e papaguar, por drejtorët sugjerojnë se ajo do të paguhet në muajt në vijim. Barna shpreson të zgjerojë ofertën e saj të produkteve dhe po shqyrton blerjen e një kompanie bioteknologjike, FarmBio Shpk. (Farmbio), e cila është investuar shumë në kërkim dhe zhvillim. Drejtori i financave të Barna ka kërkuar këshilla nga firma juaj në lidhje me këtë blerje nga pikëpamja e taksave dhe financave të korporatave dhe ka ofruar pagesën e tarifave për shërbimin në mënyrë kontigjente. FarmBio iu afrua firmës tuaj vitin e kaluar për punën e vlerësimit të financave të korporatës dhe një vlerë prej 3,000,000 € u vendos në FarmBio. Drejtori i financave të Barna ka kërkuar që partneri i auditimit të A1 Audits të marrë pjesë në mbledhjen e ardhshme mujore të bordit të kompanisë. Djali i partnerit të auditimit është emëruar gjithashtu kohët e fundit si asistent marketingu në Barna me kohë të plotë.

Kërkohe

- (a) Përgatitni një memorandum për menaxherin tuaj, duke vlerësuar në mënyrë kritike çështjet etike të paraqitura nga skenari i mësipërm. Vlerësoni kërcënimet ndaj pavarësisë dhe rekomandoni masat mbrojtëse, nëse ka, që mund të përdoren për të ulur kërcënimet në një nivel të pranueshëm. (12 pikë)
- (b) Rekomandoni përgjigjen e duhur të auditimit kur një auditor zbulon mashtrim në një angazhim auditimi të klientit. (8 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja
 Memo
 Për: Menaxherin
 Nga: Seniori i auditimit
 Çështjet etike

Çështja	Kërcënimi i pavarësisë	Masat mbrojtëse
Auditimi i kompanisë për 15 vite – shoqërimi i gjatë	Kërcënimi i familjaritetit Kërcënimi i interes vetiak	Ndryshimi i rolit të individit në ekipin e auditimit ose natyrës dhe shtrirjes së detyrave që kryen individit Rishikimi i punës së anëtarit të ekipit Kryerja e rishikimive të klontrollit të cilësisë
Tarifat e auditimit si përqindje e të hyrave totale të firmës	Interesi vetiak Frikësimi	Rritja e bazës së klientëve për të zvogëluar varshmërinë në një klient të auditimit – kjo mund të jetë e vështirë Për entitetet me interes public nëse shumica e tarifës tejkalon 15% të të hyrave totale të firmës, firma duhet të: Shpalos këtë fat PNMQ, dhe Të diskutoj nëse masat në vijim mund të konsiderohen si masa mbrojtëse të mjaftueshme -Para nënshkrimit të raportit – të bëhet një rishikim i punës së auditimit nga një anëtarë i cili nuk ishte pjesë e ekipit -Pas nënshkrimit të raportit të auditimit – të kryhet rishikim i kontrollit të cilësisë së angazhimit
Tarifat e auditimit nga viti i kaluar ende nuk janë paguar	Interesi vetiak	Përftimi i pagesës së pjesërishme Rishikimi i punës së auditimit Nëse shumica është e rëndësishme – të konsiderohet nëse kjo përfaqëson hua për klientin Të vlerësohet nëse auditori duhet të vazhdojë me angazhimin
Këshilat tatimore dhe shërbimet e financave të korporatës të paguhen në bazë kontingjente	Interesi vetiak	Firma e auditimit nuk duhet të ngarkojë tarifa kontingjente

Kërkesa që partneri të merr pjesë në takimet e bordit	Interesi vetiak Vetërishtikimi Familjariteti	Partneri i auditimit nuk duhet të merr pjesë në takime të bordit të klientit. Roli i firmës së auditimit është jep opinion të pavarur mbi pasqyrat financiare.
Djali i partnerit të auditimit është emëruar nga klienti	Interesi vetiak Familjariteti Frikësimi	Një kërcënim paraqitet kur një drejtor, zyrtar i klientit është në pozitë të ndikojë një çështjen që auditohet Për të zvogëluar këtë kërcënim duhet që anëtari i ekipit të mos merret me çështjen që është përgjegjësi e familjarit Për derisa djali i partnerit është punësuar is asistent në marketing, kjo pozitë nuk përfshinë përgatitjen e pasqyrave financiare, prandaj kërcënimi mund të jetë i vogël.

b) Përgjigjet e duhura ndaj mashtrimit ose mashtrimit të dyshuar mund të gjenden në ISA 240 - Përgjegjësitë e Auditorit në lidhje me mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare.

Auditori duhet të mbajë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit.

Nëse zbulohet një mashtrim i dyshuar, si senior i auditimit në këtë skenar të veçantë, ne do të ndërmarrim sa vijon:

- Dokumentoni se si dhe ku pasqyrat financiare të entitetit mund të jenë të ndjeshme ndaj anomalive materiale për shkak të mashtrimit duke përfshirë mënyrën se si mund të ndodhë mashtrimi.
- Kur përgjigjet ndaj pyetjeve të menaxhmentit ose atyre të ngarkuar me qeverisjen janë të paqëndrueshme, auditori duhet të hetojë mospërputhjet.
- Vlerësoni nëse informacioni është marrë nga procedurat e tjera të vlerësimit të rrezikut dhe aktivitetet përkatëse të kryera që tregojnë që një ose më shumë faktorë rreziku mashtrimi janë të pranishëm.
 - Dokumentoni gjetjet e deritanishme dhe diskutoni me partnerin e auditimit/partnerin etik brenda firmës tuaj për të vendosur se çfarë hapi tjetër duhet të ndërmerret dhe nëse mashtrimi është padyshim i dukshëm.

Faktorë të tjerë për t'u marrë parasysh do të ishin:

- Vlerësoni dëshminë e ofruar të auditimit
- Të përcaktojmë përgjegjësitë tona profesionale dhe ligjore dhe nëse është e përshtatshme të tërhiqemi si auditorë
- Nëse tërhiqemi, duhet të diskutojmë me nivelin e duhur të menaxhimit dhe me ata që janë të ngarkuar qeverisja për tërheqjen e auditorit nga angazhimi dhe arsyet e tërheqjes
- Përcaktoni nëse ekziston një kërkesë profesionale ose ligjore për t'i raportuar personit ose personave që bëri emërimin e auditimit ose, në disa raste, tek autoritetet rregullatore
- Auditorët duhet gjithashtu të marrin përfaqësime me shkrim dhe të dokumentojnë korrespondencat me PNMQ në lidhje me përgjegjësitë e tyre. Ata duhet t'i shpallin auditorëve të tyre njohuri për çdo pretendim për mashtrim ose mashtrim të dyshuar, që ndikon në pasqyrat financiare të entetit.